



Prishtinë, 15 tetor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1055\_2018

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 19, 20 dhe 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V\_768\_2016 të datës 28 janar 2016;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V\_882\_2017 të datës 09 shkurt 2017 lëshuar shoqërisë "Eurokos JH" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Restelica 3 në rrjedhën e lumit Restelica me kapacitet të instaluar prej 1.49 MW, ZK Globoqic, komuna e Dragashit; dhe
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V\_882\_2017 të datës 09 shkurt 2017 për ndryshimin e kapacitetit instalues nga 1.49 MW në kapacitetin total instalues prej 2.35 MW për Hidrocentralin HC Restelica 3 që është duke u ndërtuar në ngastrën kadastrave nr. 1210-1 ZK Globoqic, Komuna e Dragashit, të datës 27.09.2018 të shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., me adresë rruga "Migjeni" Nr. 23 -10000 Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Vendimi nr. 783/18 –ZSP- 1090/2018 të datës 12.09.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1782 -2/11 – ZSP- 486/13 dt. 21.06.2013 për HC HC Restelica 3, nga N=1.49 MW në N=2.35 MW në segmentin ujour, nga Kuota 1355.41 ml.m, deri në Kuotën 1251.0 m.l.m., të lëshuar nga MMPH;
- Kontrata për furnizim me turbina nga prodhuesi Feroinvest, dokumentacionin tekniko – investiv dhe vlerësimin financiar të projektit,

në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2018 nxori këtë:

## V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K. dhe **MODIFIKOHET VENDIMI PËR AUTORIZIMIT FINAL V\_882\_2017** i datës 09 shkurt 2017, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Restelica 3 nga kapaciteti instalues prej 1.49 MW në kapacitetin total instalues prej **2.35 MW** ngastrë kadastrave nr. 1304 ZK Globoqic sipas Vendimit nr. 783/18 –ZSP- 1090/2018 të datës 12.09.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1782 -2/11 – ZSP- 486/13 dt. 21.06.2013 për HC Restelica 3, nga N=1.49 MW në N=2.35 MW në segmentin ujour, nga Kuota 1355.41 ml.m, deri në Kuotën 1251.0 m.l.m., të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).



- II. **OBLIGOHET** - shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., pas përfundimit të punëve ndërtimore sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi, të aplikon për Certifikatë të Përdorimit pranë organit kompetent Komunal sipas Ligjit të Ndërtimit.
- III. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij vendimi, gjeneratori “Eurokos JH” SH.P.K., do të hyn në Operim komercial sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent.
- IV. Shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., do të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) nga MMPH.

### Arsyetim

- ZRRE me datë 27.03.2015 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Restelica 3, me kapacitet të instaluar prej 1.49 MW, në lokacionin ZK Glloboqic, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- Bordi i ZRRE-së pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 28 janar 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_768\_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- ZRRE me datë 16.01.2017 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Restelica 3, në Lumin Restelica, me kapacitet të instaluar prej 1.49 MW komuna e Dragashit duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ujore, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga Komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE me datë 09 shkurt 2017 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V\_882\_2017 shoqërisë “Eurokos JH” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në rrjedhën e Lumit Restelica me kapacitet të instaluar prej 1.49 MW, ZK Restelica, komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë 27 shtator 2018 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V\_882\_2017 të datës 09 shkurt 2017 për Modifikimin/ndryshimin e kapacitetit instalues nga 1.49 MW në kapacitetin total instalues prej 2.35 MW për Hidrocentralin HC Restelica 3 që është duke u ndërtuar në ngastrën kadastrave nr. 1304 ZK Glloboqoc, Komuna e Dragashit.
- ZRRE s’bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final ka pranuar dëshmitë dhe atë: Vendimin nr. 783/18 –ZSP- 1090/2018 të datës 12.09.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1782 -2/11 – ZSP- 486/13 dt. 21.06.2013 për HC Restelica 3, nga N=1.49 MW në N=2.35 MW në segmentin ujqor, nga Kuota 1355.41 ml.m, deri në Kuotën 1251.0 m.l.m., të lëshuar nga MMPH, kontratën për furnizim me turbina nga prodhuesi Feroinvest, dokumentacionin tekniko – investiv dhe vlerësimin financiar të projektit.



- Shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: gjatë ndërtimit të Hidrocentralit HC Restelica 3 sipas Autorizimit Final të lëshuar nga ZRRE, përmirësimi i parametrave gjeologjike dhe ekologjike të parapara me studimin e ridizajnuar të fizibilitetit kanë rezultuar në optimizimin e këtij hidrocentrali.
- Gjithashtu kompania gjatë procesit të përzgjedhjes së llojit të turbinave dhe studimeve të bëra në teren me propozim të prodhuesit të turbinave dhe matjeve të bëra, ka ardhur deri të zgjedhja e turbinave me kompaninë Feroinvest për kapacitetin e kërkuar nga ai. Prodhuesi ka sugjeruar të pajisjeve me dy turbina francis që në total 2.35 MW, për shfrytëzimin e prodhimit të energjisë në mënyrë efikiente, si dhe mos ngarkimin e pajisjeve me kapacitet maksimal, por të shfrytëzohet kapaciteti normal për ruajtjen e turbinave dhe të jetëgjatësisë së tyre.
- Shoqëria thekson që pas konsultimit me ekspertët e kësaj lëmie dhe propozimeve të prodhuesit, ka vendosur që pas kompletimit të ndryshimit të lejes dhe pëlqimeve të nevojshme të lëshuar nga organi kompetent që të pajiset me turbina sipas rekomandimit të prodhuesit.
- Andaj, bazuar në këtë që tha më lartë dhe dokumentet e bashkangjitura, përfshirë edhe vendimin për ndryshimin e Lejes Ujore të lëshuar nga MMPH në mbështetje të kërkesës, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 19 të Rregullës së Autorizimit të aprovon modifikimin e autorizimit final dhe të iu mundësohet ndryshimi i kapacitetit instalues nga 1.49 MW në kapacitetin total prej 2.35 MW, ndërsa pjesët tjera të projektit mbeten të pa ndryshuara.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmimeve të bashkangjitura, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa për modifikim është e bazuar, dhe dëshmitë e bashkangjitura janë bazë e mjaftueshme për të lejuar Modifikimin e Autorizimit Final V\_882\_2017 të datës 09 shkurt 2017, dhe ndryshimin e kapacitetit instalues nga 1.49 MW në kapacitetin total prej 2.35 MW bazuar në Vendimin nr. 783/18 –ZSP- 1090/2018 të datës 12.09.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1782 -2/11 – ZSP- 620/12 dt. 23.08.2012 të lëshuar nga MMPH, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Dragashit
- Sekretarit të MMPH-së, dhe
- Arkivit të Rregullatorit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar